

## Informacion rreth Aktiviteteve të Strukturës të Integritit pranë Bashkisë Dibër.

### 1. Dibër sesion informues në kuadër të programit EU For Innovation

19 Shtator 2019 - Këndi i BE-së në Bashkinë Dibër në bashkëpunim me përfaqësues të programit EU For Innovation realizoi sesionin informues në kuadër të thirrjes të dytë për ide inovative për mbështetjen e start-up's dhe bizneseve nëpërmjet EU Challenge Fund. Pjesë e këtij sesioni informues ishin target grupe të ndryshme që nga të rinjtë, OJF, bizneset lokale etj... Ky session kishte si synim të frymëzojë pjesëmarrësit dhe t'i nxisë ata të zbulojnë potencialitetin e plotë të bizneseve të tyre dhe të gjejnë metoda sfiduese dhe inovative për të implementuar idetë e tyre.



### 2. Rrënjët e qytetit tim

Dibër, 09 Maj 2019 – Njësia për Koordinimin e Integritit Evropian dhe Ndhimës së Huaj, në Bashkinë Dibër, në kuadër të serisë së aktiviteteve që Këndet e BE-së në të 61 bashkitë e Shqipërisë po zhvillojnë për Javën e Evropës, ka organizuar vizita studimore në dy muzetë e qytetit të Dibrës, për të rinjtë e shkollave 9-vjeçare.

Nën mesazhin “Rrënjët e qytetit tim”, si dhe duke arsyetuar mbi vlerat evropiane të trashëgimisë historike dhe asaj kulturore, studentët janë njohur me historinë e qytetit të tyre, trashëgiminë kulturore, ndërkohë që nga ana e koordinatorit të Këndit të BE-së, u është bërë një panoramë e shkurtër e mbështetjes që Bashkimi Evropian u jep të rinjve. Nëpërmjet shumëllojshmërisë së programeve të tij.

Përveç vizitës në muze, është organizuar dhe një minikonkurs ndërmjet nxënësve të dy shkollave 9-vjeçare të qytetit, në qendër të të cilit kanë qenë pyetje që vlerësuan njohuritë e tyre mbi Bashkimin Evropian dhe rrugën e Shqipërisë drejt integritimit.

Përgjatë gjithë zhvillimit të aktiviteteve, të pranishëm kanë qenë nxënës të shkollave 9-vjeçare, mësues, përfaqësues të muzeut dhe përfaqësues nga Bashkia Dibër.



### 3. Fushatë publike kundër dhunës ndaj grave

Në datën 7 Dhjetor 2018 Këndi BE në Bashkinë Dibër në bashkëpunim me AgritraVision dhe me mbështetjen e projektit Bashkitë për në Evropë ndërmori fushatën "Fushatë publike kundër dhunës ndaj grave".

#### **Qellimi i këtij aktiviteti ishte**

- Ndërgjegjësimi i shoqërisë për uljen e fenomenit të dhunës kundër grave dhe vajzave në rrethin Dibër
- Ndërgjegjësimi i grave dhe vajzave që të ngrenë zërin dhe të denoncojnë rastet e dhunës në familje, komunitet etj

#### **Në kuadër të kësaj fushate u ndërmorën disa aktivitete:**

- Marshim me mesazhe kundër dhunës nëpërmjet fletëpalosjeve, banerit dhe posterave.
- Këndi me fletëpalosje dhe fjongo portokalli.
- Vendosja e posterave me mesazhe kundër dhunës.



#### 4. Sesion informimi rreth Programit të Vetëpunësimit

Në datën 31 Tetor 2018, Këndi i BE Dibër u bë pjesë e Programit të Vetëpunësimit nga UNDP i cili mbështet të rinjtë që kanë dëshirën dhe vizionin për të ndërtuar biznesin e tyre.

Gjatë këtij sesiioni informimi të rinjtë deri në moshën 30 vjeç u informuan rreth mundësive për të aplikuar me një ide të konsoliduar biznesi të mbështetur nga ky program.



#### 5. Netët e Filmit Evropian në Dibër

Në datat 7-8 Tetor 2018 Bashkia Dibër dhe Këndi i Bashkimit European në këtë qytet organizuan aktivitetin “Netët e Filmit Evropian”.

Pas shumë vitesh me mbështetjen e Projektit “Bashkitë për në Evropë” edhe në qytetin e Peshkopisë u zhvillua “Open Cinema”, ku gjatë mbrëmjeve të këtyre dy ditëve për publikun u transmetuan dy filma të kinemasë së huaj.

Gjatë këtyre dy ditëve u krijua një atmosferë festive për Filmin Evropian, ku rinia Dibrane përcolli dy netë bukurinë e ekranit të madh nëpërmjet filmave “Pitkini në Spital” dhe “Rrjeti i Krimit”.



## 6. Erasmus +, Youth in Action

Bashkia Dibër në bashkëpunim me Qendrën për progress Rinor sëbashku me aktivistë të shoqërisë civile dhe zyrtarë të qeverisjes vendore organizuan aktivitetin për të promovuar Erasmus+ Youth In Action.

EUCronerPeshkopi  
SALTOSEE  
Erasmus+



## 7. Këndi BE Dibër , në datën 17 Qershor ishte pjesë e Panairit Rajonal të Punës, që u zhvillua në rrethin e Dibrës për herë të parë

Këndi BE Dibër, në datën 17 Qershor i'u bashkua Panairit Rajonal të Punës pjesë e të cilit ishin , mësues , nxënës , qytetarë, feremrë, sipërmarrës, të cilët shprehën interes rreth Këndin të BE dhe informacioneve dhe mundësive që ai ofron. Gjatë këtij panairi pjesmarrësit u informuan rreth mundësive, emigracionit të parregullt, Erasmus +, IPARD II...



## 8. Këndi i BE-së Dibër zhvilloi Forumin e hapur publik me të rinjtë në Dibër në kuadër të Javës Evropiane

Në datën 10 Maj 2017, në kuadër të Javës Evropiane, Këndi i BE-së Dibër zhvilloi aktivitetin “Zëri im në Planifikimin e Qytetit” ku të rinjtë e qytetit të Peshkopisë shprehën idetë e tyre rreth mundësive që mund t’u ofrohen atyre. Gjatë këtij aktiviteti u diskutua rreth qytetarisë aktive dhe se si të rinjtë mund të luajnë një rol më aktiv në jetën sociale, kulturore, sportive etj të qytetit.

Pjesë e aktivitetit ishte edhe Drejtoresha e SHKR (Drejtoresha e Shërbimi Kombëtar për Rinine, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë) Lorena Haxhiu e cila bëri njoftimin e hapjes së një Qendre Rinore për të rinjtë në qytetin e Peshkopisë.



## 9. **Kendi i BE Dibër organizoi në datën 5 Mars 2018 aktivitetin “Mësojmë për Bashkimin Evropian”**

Kendi i BE Dibër organizoi në datën 5 Mars 2018 aktivitetin “Mësojmë për Bashkimin Evropian” me nxënësit e Shkollës “Irfan Hajrullahi” në ambientet e kësaj shkolle në Peshkopi.

Gjatë këtij aktiviteti, Koordinatorin e Këndit të BE-së së bashku me Koordinatorin back-up në Dibër bënë një prezantimin të shkurtër rreth librit “Misteri i Yjeve të Arta” si dhe një prezantim në lidhje me Bashkimin Evropian, historikun e tij që prej krijimit e deri në ditët e sotme. Njëkohësisht, nxënësit patën mundësi të marrin edhe materiale informuese në lidhje me BE.

